



Memorandum i Bashkëpunimit

Në mes të OJQ PEN dhe Komunës së Drenasit

Ky memorandum i bashkëpunimit ("MoU") nënshkruhet nga:

OJQ Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshatar– PEN (kontraktuesi), si organ juridik që administron programin UNICEF Innovations Lab Kosovo, adresa: Rr. Behije Dashi, Nr.7, kati I 3-të, Prishtinë, Kosovë, dhe **Komuna e Drenasit**, adresa: Rr. "Fehmi Lladrovci", Drenas, Kosovë

Prej nga, OJQ PEN do të bashkëpunojnë për mbështetjen e grupit "A bon me rujtë parkun", grup i formuar në kuadër të programit Podium nga UNICEF Innovations Lab Kosovo në partneritet me OJQ PEN, i cili ka për qëllim riparimin dhe riaktivizimin e këndit të lojërave në parkun e qytetit në Drenas.

OJQ PEN/ILK do të jetë përgjegjës për sigurimin e hapave në vazhdim, në kuadër të bashkëpunimit:

- Mbështetjen financiare të grupit "A bon me rujtë parkun" në vlerë prej 500 euro, për blerjen e lodrave të reja dhe riparimin e lodrave ekzistuese në parkun e qytetit në Drenas;
- Angazhimi i vullnetarëve të rinj në asistimin e grupit për rregullimin e parkut;
- Monitorimin dhe asistimin e vazhdueshëm të këtij grupi në implementimin e kampanjës së tyre;

Në rast se shpenzimet për pikën e parë nuk e arrijnë shumën e paraparë (500 euro), fondet e mbetura do të përdoren për:

R. H


- Mbeshtetje financiare për shtimin e hapësirave të gjelbra, (mbjelljen e fidaneve të reja, si: pisha dekorative, lloje drunor Bli, kumbull e egër, lule dekorative shumëvjeqare etj);
- Rregullimin i infrastrukturës për hedhjen e mbeturinave;
- Rregullimin e pushimoreve (ulëseve në këndet e lodrave).

Për më tepër, Komuna e Drenasit do të jetë përgjegjëse për:

- Sigurimin e zhavorrit,
- Sigurimin e ngjyrave të ndryshme për ngjyrosje,
- Monitorimin dhe asistimin e vazhdueshëm të këtij grupi në implementimin e kampanjës së tyre;
- Si dhe bashke-organizimin e përrurimit të parkut të lodrave për fëmijë.

Kohëzgjatja e Memorandumit të Bashkëpunimit

Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, Memorandumi i Bashkëpunimit do të jetë në fuqi deri më 31 dhjetor 2019, me mundësi vazhdimi sipas marrëveshjes. Në rastin kur njëra palë shpreh dëshirë të tërhiqet nga bashkëpunimi, duhet të dërgohet kërkesë në formë të shkruar, dy javë më herët.

Bujar **FEIZULLAHU**

 Executive Director
 Peer Educators Network – PEN

